



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.869/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha, kryetar kolegji, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtare të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit/kundërpaditurit Komuna e Prishtinës me seli në Prishtinë, ndaj të paditurit/kundërpaditësit NPT Douglas me seli në Podujevë, të cilin me autorizim e përfaqëson L.B.Y. avokate nga Prishtina, me bazë juridike: kompensim dëmi për mos përmbushje të kontratës dhe kundërpadisë me objekt kontesti pagesë e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesat e palëve ndërgjyqëse, të parashtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për çështje ekonomike, K.E.nr.418/22 të datës 30.03.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 08.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN si të pabazuara, Ankesa e paditësit/kundërpaditurit Komuna e Prishtinës me seli në Prishtinë, dhe Ankesa e paditurit/kundërpaditësit NPT Douglas me seli në Podujevë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për çështje ekonomike, K.E.nr.418/22 i datës 30.03.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar K.E.nr.418/22 të datës 30.03.2023, Dhoma e shkallës së parë, ka vendosur si në vijim: I. Refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit/kundërpaditurit Komuna e Prishtinës, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri/kundërpaditësi NPT Douglas, që t,ia kompensoj dëmin për mos përmbushje të kontratës numër 616-14-091-111 me kamatë ligjore në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, II. Refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e të paditurit/kundërpaditësit NPT Douglas, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet paditësi/kundërpadituri Komuna e Prishtinës, që në emër të borxhit për furnizimin dhe montimin e dollapëve sipas kontratës nr.616-14-091-111 datës 15.10.2014, t,ia paguaj shumën prej 12,338.60€ me kamatë ligjore prej 8% nga data 19.01.2015 e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm, III Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor kanë paraqitur ankesë përfaqësuesit e autorizuar të dyja palët ndërgjyqëse.

I autorizuari i paditësit/kundër të paditurit SHA Sejdiu&Qerkini me seli në Prishtinë, e kundërshton aktgjykimin e atakuar K.E.nr.418/22 të datës 30.03.2023, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, zbatimit të gabuar të drejtës materiale dhe vërtetimit o të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, me propozimin që Dhomat e shkallës së dytë, të aprovoj ankesën e paditësit/kundër të paditurës Komuna e Prishtinës në tërësi si e bazuar, të Anulohet pika I e aktgjyimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për çështje ekonomike, K.E.nr.418/22 i datës 30.03.2023, si i kundërligjshëm, dhe sa i përket pikës I të dispozitivit, çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje, Detyrohet e paditura/kundërpaditësja që paditësit/kundër të paditurës Komuna e Prishtinës, t,ia paguaj shpenzimet e procedurës nga neni 452 të LPK-së.

E autorizuar e paditurit/kundërpaditësit L.B.Y. avokate në Prishtinë, e ankimon aktgjykimin e lartcekur, për shkak të shkeljeve të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, si dhe vendimit për shpenzimet procedurale, me propozim që të Ndryshohet aktgjykimi i atakuar, në pikën II të dispozitivit, ashtu që kundërpadia e të paditurit/kundërpaditësit të Aprovohet në tërësi si e bazuar dhe të Detyrohet paditësi/kundër i padituri që në emër të borxhit për furnizim dhe montimin e dollapëve sipas kontratës nr.616-14-091-11 dt.15.10.2015 t,ia paguaj shumën prej 12,338.60€, me kamatë ligjore 8% si dhe të detyrohet të kompensoj shpenzimet procedurale, apo aktgjykimi të priset dhe çështja të i kthehet Dhomës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Dhomat e Shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja Komuna e Prishtinës me datën 27.08.2025, me datën 27.08.2015 ka paraqitur padi pranë gjykatës së shkallës së parë, kundër të paditurit NTP Douglas,nga Podujeva, për shkak të kompensimit të dëmit. Për mos përmbushje të kontratës nr.616-14-091-111. Ndër të tjera në padi dhe gjate seancave gjyqësore, paditësi ka pretenduar se i padituri nuk e ka përmbush kontratën për furnizimin dhe montimin e dollapëve në Shkollat fillore të Komunës së Prishtinës, dhe nuk ka vepruar sipas kontratës dhe kushteve të përcaktuara në kontratë, duke i propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si e bazuar padia e paditësit.

I padituri NTP Douglas,nga Podujeva, me datën 27.05.2016 ka paraqitur kundërpadi ndaj paditësit Komuna e Prishtinës, me pretendimet se padia e paditësit nuk është e mbështetur në prova por në vlerësim arbitrar, duke theksuar se i padituri/kundërpaditësi ka kualifikime në fushën e drurit dhe ka kryer një numër të madh të projekteve në institucionet tjera të vendit, dhe në raportin kontraktues me paditësin/kundër të paditurin, i ka kryer të gjitha punimet sipas kontratës dhe për këto punime ka lëshuar fatura, një pjesë e të cilave janë paguar nga paditësi, pretendon se paditësi i ka mbetur borxh kundër paditësit edhe shumën prej 12,338.60€, dhe i propozon gjykatës që të miratohet

kundërpadia dhe të detyrohet paditësi/kundër i padituri që në emër të borxhit të paguaj shumën prej 12,338.60€, me kamatë ligjore.

Dhoma e shkallës së parë, duke vepruar sipas aktvendimit Ae.nr.56/2018 datës 19.12.2019 të Gjykatës së Apelit, ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor me datën 16.03.2023 në praninë e përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, dhe pas administrimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, ka marr aktgjykimin e atakuar me të cilin ka Refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit/kundërtëpaditurit Komuna e Prishtinës dhe kërkesëpadinë e të paditurit/kundër paditësit NPT Douglas, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata bazuar në dispozitat ligjore dhe gjendjen faktike të konstatuar, ka vlerësuar se në rastin konkret kërkesat e palëve ndërgjyqëse për kompensim dëmi në njërin anë dhe pagesën e borxhit në anën tjetër janë në tërësi të pabazuara. Palët kanë qenë në marrëdhënie detyrimore sipas kontratës 616-14-091-111 dt.15.10.2014 për furnizim dhe montimin e dollapëve për shkollat fillore në Komunën e Prishtinës. Pas përfundimit të furnizimit dhe montimit të dollapëve nga i padituri, Komisioni për mbikëqyrjen e projektit me dt.21.12.2014 ka konstatuar se i padituri ka zhvilluar punimet sipas kontratës, ndërsa nga raporti i njëjtit komision dt.23.03.2015 është konstatuar se punimet nuk janë kryer sipas kushteve të përcaktuara në kontratë. I padituri është njoftuar për lëshimet dhe mos përmbushjen e kontratës dhe nga i njëjti është kërkuar që në afat prej një muaji të bëjë përmirësimin e punëve të kryera sipas vërejtjeve të dhëna në këtë njoftim, mirëpo edhe pas vërejtjeve të dhëna, i padituri nuk ka evituar të metat e konstatuara në raport, andaj për mos përmbushje të kontratës sipas vërejtjeve të dhëna i njëjti nuk ka përmbush obligimin e tij sipas faturës së fundit në shumën prej 12,338.60€. Meqë paditësja për shkak të mos përmbushjes së kontratës ka zbatuar nenin 16 të kontratës, dhe ka ndaluar një pjesë të pagesës së çmimit në emër të dënimit kontraktues, gjykata duke iu referuar nenit 257 par.1 dhe 2 të LMD-së, vlerëson se paditësja përderisa ka aplikuar dënimin kontraktues, nuk mund të kërkojë përmbushjen e kontratës e as kompensim tjetër të dëmit për të njëjtën çështje. Gjykata ka zbatuar nenin 259 par.2 të LMD-së, pasi paditësja me asnjë provë nuk ka arritur ta argumentoj se dëmi i pësuar është më i madh se shumica e ndaluar në emër të dënimit kontraktues, dhe gjatë procedurës paditësja nuk ka arrit ta identifikoj dëmin dhe precizoj shumën konkrete të kërkuar për kompensim dëmi. Gjykata vlerësoi edhe kërkesëpadinë e paditurit/kundërpaditësit për pagesën e borxhit dhe gjeti se e njëjta është e pabazuara sepse vetëtoi se i padituri/kundërpaditësi nuk ka vepruar sipas kontratës dhe nuk i ka përmbush obligimet e parapara me kontratë edhe pas dërgimit të vërejtjes nga paditësi/kundër i padituri, dhe dhënies së afatit shtesë për mënjanimin e atyre të metave, i njëjti në bazë të nenit 18 të kontratës ka pas obligim që të bëjë furnizimin konform specifikacioneve teknike të paraqitura në kontratë. Meqë i padituri/kundër i padituri nuk ka vepruar konform kushteve të përcaktuara në kontratë, dhe vërejtjeve nga paditësi/kundër padituri, i njëjti nuk ka kryer pagesën sipas faturës kontestuese, dhe në këtë rast gjykata referohet në nenin 18 të kontratës dhe nenin 104 të LMD-së.

Dhomat e shkallës së Dytë e aprovon vlerësimin juridik të dhomës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat k) dhe n) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerëson se dhoma e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale respektivisht dispozitat e nenit 257 par.1 dhe 2 të Ligji mbi Marëdhëniet e Detyrimeve, ku është përcaktuar se: 1. *Kur dënimi është kontraktuar për rast të mos përmbushjes së detyrimit, kreditori mund të kërkojë ose përmbushjen e detyrimit ose dënimin kontraktues.* 2. *Ai e humbë të drejtën për të kërkuar përmbushjen e detyrimit, në qoftë se ka kërkuar pagimin e dënimin të kontraktuar.*

Në rastin konkret nga provat e administruara respektivisht neni 16 i Kontratës 616-14-091-111 dt.15.10.2014 dt.15.10.2014 e lidhur mes dy palëve ndërgjyqëse, dhe faktit se paditësja ka zbatuar nenin 16 te kontratës, duke i ndaluar një pjesë të pagesës së çmimit paditurës në emër të dënimin kontraktues, dhe në anën tjetër faktit se paditësja nuk ka argumentuar para gjykatës se dëmi i pësuar është më i madh se shuma e ndaluar në emër të dënimin kontraktues, Kolegji vlerëson se dhoma e shkallës së parë ka vepruar drejtë kur ka vendosur me rastin e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar duke refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit/kundërpaditurit Komuna e Prishtinës, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri/kundërpaditësi NPT Douglas, që t,ia kompensoi dëmin për mos përmbushje të kontratës. E paditura/kundërpaditësi duke mos kryer detyrimin e saj kontraktues, edhe pas vërejtjeve të dhëna nga paditësja përmes Raportit datës 19.05.2015, dhe deklarimeve të ekspertit gjyqësor në seancën dëgjimore datë 25.01.2018 se nuk përputhen specifikimet me vizatimin teknik, rezulton se e paditura nuk ka përmbush obligimin e tij sipas faturës së fundit në shumën prej 12,338.60€, prandaj në këtë rast Kolegji vlerësoi se me të drejtë është zbatuar neni 257 par.1 dhe 2 të LMD-së, kur është dhënë konstatimi se me rastin e aplikimit të dënimin kontraktues nga paditësja sipas nenit 16 te Kontratës, atëherë i njëjti e humb të drejtën për të kërkuar përmbushjen e kontratës.

Kolegji i Dhomave të shkallës së dytë, nuk i aprovoi si të bazuara pretendimet e paditësit/kundërpaditurit se gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë për bazë faktin se e paditura nuk ka bërë montimin profesional të rafteve nëpër shkollat e mesme të ulëta, se aktgjykimi i atakuar është në kundërshtim me nenin 182 par.2 pika (n) e LPK-së, konstatimi i gabuar i gjendjes faktike qëndron në atë se me anë të ekspertizës është konstatuar shkelje e Kontratës duke mos iu përmbajtur specifikacioneve të materialit të punuar, dhe gjykata nuk e ka trajtuar fare këtë fakt duke mos e obliguar në kompensimin e dëmit të paditurën. Kolegji vlerësoi se në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka administruar dhe trajtuar në arsyetim të aktgjykimit, konstatimet e ekspertit gjyqësor F.K. e viti 2017 dhe deklarimet e të njëjtit ekspert në seancën gjyqësore datës 25.01.2018, duke konfirmuar shkeljet e kontratës sa i përket specifikave ABS mm. Kolegji vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të

së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërshtim me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike,

Po ashtu Kolegji i Dhomave të shkallës së dytë, vlerësoi pretendimet ankimore të paditues/kundërpaditësit se ka përmbush detyrimet nga raporti kontraktues por paditësi nuk i ka paguar borxhin e mbetur dhe se gjykata e shkallës së parë në arsyetim e saj ka ardhur në përfundim pa u vërtetuar nëse është shkaktuar dëm nga e paditura pa angazhuar fare ekspert të lëmis përkatëse, si dhe kundërshton aktgjykimin e atakuar për shkak të tejkalimit të autorizimeve ligjore për shkak se nuk është administruar plotësimi i ekspertizës së ekspertit të drurit si provë në procesverbalin e datës 15.02.2023, mirëpo këto pretendime Kolegji i vlerësoi si të pabazuara, sepse i njëjti nuk iu ka përmbajtur nenit 18 të Kontratës sa i përket cilësisë së furnizimeve duke mos i evituar përmirësimet e punëve të kryera, sipas vërejtjeve të dhëna nga paditësi me Raportin e datës 19.05.2015, dhe në këtë rast gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka zbatuar nenin 104 të LMD-së. Kolegji vlerësoi se nuk kemi tejkalim të autorizimeve ligjore në rastin konkret, për arsye se në arsyetim të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë përveq konstatimeve në ekspertizën gjyqësore vitit 2017, ka trajtuar si plotësim të ekspertizës, deklaratimet e ekspertit gjyqësor F.K. ekspert nga lëmia e drurit, i cili në seancën gjyqësore datës 25.01.2018 është deklaruar verbalisht lidhur me pyetjet e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse.

Dhomat e shkallës së dytë, i vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse dhoma e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë e ka zbatuar të ligjin material, ndërsa pretendimet e palëve ankimore janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së dytë

K.DH.SH.II.nr.869/2023 datë 08.02.2024

Kryetari i Kolegjit – Gjyqtari  
Krenar Berisha